

Boshnjakët dhe sfidat e modernitetit – periudha e vonë osmane dhe hapsburge

Prof. Dr. Fikret Karcic
Sarajevë

Recension kritik nga:

Doc.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

DOKTOR I TEFSIRIT KUR'ANOR
Community College - Taibah University
Medina e ndritshme
Mbretëria e Arabisë Saudite

Përktheu nga anglishtja:
Edin Q. Lohja

2009

PËRMBAJTJE

Pjesa e parë Jetëshkrim i shkurtër i autorit	2
Pjesa e dytë PËRMBLEDHJE	3
Pjesa e tretë MERITA TË LIBRIT	6
Pjesa e katërt MANGËSI TË LIBRIT	12
Pjesa e pestë KRITIKË E JASHTME	21
Pjesa e gjashtë PËRFUNDIMI	23

بسم الله الرحمن الرحيم

Hyrje

Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun Fuqiptotë (S.V.T). Paqja dhe bekimet e Tij janë për të dërguarin e Tij të fundit, të dashurin tonë Muhammedin a.s., mbi Shoqëruesit dhe ndjekësit e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Lexues të nderuar! Jam shumë i gëzuar të paraqes një recenzim islam të librit të profesorit tim të dashur boshnjak Dr. Fikret Karcic, me titull *Boshnjakët dhe sfidat e modernitetit*.

Ndodhia e këtij recenzimi kthehet pas në ditët e studimeve të mia pasuniversitare për doktoraturë në Universitetin e Malajzisë, më 2000, kur profesori im i nderuar më jepte kursin e Metodologjisë së Kërkimit Shkencor.

Profesori im i dashur zakonisht u kërkonte studentëve detyrat e kursit, dhe u habita shumë kur më nderoi me kërkesën për të shkruajtur një recenzim dhe paraqitje kritike të librit të tij më të fundit. Në fillim refuzova sepse nuk e shihja veten në lartësinë e duhur për këtë detyrë. Mirëpo ai ngulmoi disa herë që unë ta kryeja këtë detyrë dhe në fund nuk kisha zgjedhje tjetër, përveçse të pranoja.

Lavdi pastë Allahu, që ma hapi zemrën dhe unë fillova ta lexoj librin e tij me kujdes, duke bërë shënime dhe komente kritike brenda shtrirjes së formimit tim islam.

Studimin e profesorit e pashë të ishte një kontribut me vend, i barazpeshuar, i saktë dhe i thuktë në këtë fushë.

Shpresoj që lexuesit e çmuar do të përfitojnë nga ky recenzim kritik. Ai do të jetë i dobishëm për ta në mënyrë që të kenë një ide dhe informacion elementar rreth muslimanëve të Bosnjës, dhe disa prej sfidave me të cilat janë përballur ata gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Në fund, lutem që profesori im i dashur të jetë i kënaqur nga ky recenzim i. Kam përfituar shumë nga punimi i profesorit, dhe ai do të mbetet në zemrën time gjersa të vdes.

Studenti i singertë i Profesor Karcic

Dr.Hajredin Hoxha
Medina e Ndritshme
Mbretëria e Arabisë Saudite

Pjesa e parë

Jetëshkrimi i autorit dhe hollësitë e librit

PROF.DR.FIKRET KARCIC u lind në qytetin lindr të Bosnjës të Vishegradit më 1955. Ai e kreu arsimin e mesëm në Medresenë Gazi Husrev Beg, qendrën më të famshme islame në Sarajevë. Më 1978, ai u diplomua nga fakulteti i juridikut të Universitetit të Sarajevës. Gjithashtu, ai mori gradën e magjistraturës më 1985 si dhe doktoraturën më 1989 nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Beogradit.

PROF. FIKRET KARCIC ka dhënë mësim në mjaft universitete ndërkombëtare, në Fakultetin e Studimeve Islame në Sarajevë, në Universitetin e Marmarasë në Stamboll, si dhe në Fakultetin e Dijes së Shpallur dhe Shkencave Njerëzore, në Universitetin Ndërkombëtar Islam në Malajzi etj.

Libri i këtushëm u botua së pari më 1999 nga Shtëpia Botuese El-Kalem e Rijasetit të Bashkësisë Islame të Bosnjë Hercegovinës, në Sarajevë, dhe u shtyp e u lidh nga *GRIN Gracanica*. Katalogimi nga: *Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Bosnjë Hercegovinës, Sarajevë*.

Ndër botimet e tij në boshnjakisht janë titujt e mëposhtëm:

- 1- *Gjykatat e Sheriatit në Jugosllavi 1918-41*, botuar në Sarajevë, 1985.
- 2- *Aspekte shoqërore dhe ligjore të reformizmit islam*, Sarajevë, 1990.
- 3- *Studime në Ligjin islam*, Sarajevë, 1998.
- 4- Bashkë-redaktor: *Ligji islam në shoqëritë bashkëkohore*, Sarajevë, 1998.
- 5- *Historia e ligjit islam në Bosnjë Hercegovinë*, Stamboll, 1993, në arabisht dhe turqisht.
- 6- “*Posti i Reisul-ulemasë tek boshnjakët*”, në *Diskutime intelektuale*, 1997.
- 7- “*Maktab-i Nuwwab of Sarajevo*” në *A Bosnian Contribution to Muslim Education*, IRKHS, Research and Information Bulletin, 1996.
- 8- “*A History of the Office of Mufti in our Lands*”, në *Takvim*, Sarajevë 1987.

Përmbledhje e librit

Profesori i respektuar ka synuar të shkoqisë ndikimin e modernitetit gjatë periudhës së Tanzimatit në sundimin e vonë osman dhe astro-hungarez në Bosnjë dhe Hercegovinë. Gjithashtu, ai është përpjekur të diskutojë përgjigjet e intelektualëve muslimanë ndaj kësaj dukurie fetare, kulturore dhe shoqërore evropiane.

Osmanët sunduan Bosnjën nga 1463-1878, dhe gjatë shekullit të fundit të sundimit të tyre ata filluan të fusnin reforma modernizuese, të cilat u bënë të njohura si periudha e Tanzimatit (reorganizmit, ristrukturimit, rirënditjes dhe rirregullimit). Këto reforma modernizmi u zbatuan në bashkësinë boshnjake nëpërmjet zaptimeve ushtarake, si dhe ndryshimeve graduale në jetën shoqërore.

Bashkësia boshnjake ka kaluar katër regjime të ndryshme në historinë e saj:

1. Nga 1463-1878, ata ishin nën sundimin islam osman.
2. Nga 1878-1918, ata ishin nën sundimin austro-hungarez, të njohur si sundimi hapsburgas.
3. Nga 1918-1941, ata ishin nën sundimin e Jugosllavisë Mbretërore.
4. Gjatë katër viteve të Luftës së Dytë Botërore ata u bashkangjitën në fashistin “*Shtet i pavarur i Kroacisë*” dhe nga 1945-1991 Bosnja u qeveris nga Federata Socialiste Jugosllave.
5. Më 1995 Bosnja u bë e pavarur pas një lufte të përgjakshme dhe gjenocidi nga regjimi serb.

Hapat e modernizimit

Së pari, modernizimi evropian theksonte reformat dhe ndryshimet në stilin dhe veshjen e ushtrisë osmane, dhe mosdëshirën për t’u përballur me qëndresën e muslimanëve edhe pse ua ndryshonin parimet e tyre tradicionale-fetare. Kështu që filluan të reformonin çështje dytësore tradicionale, dhe më vonë u krye kodifikimi i pronësimit të tokës, legjislativit dhe arsimit. Të gjitha këto ndryshime ndodhën në vitet 1860’. Gjatë këtij dhjetëvjeçari Bosnja pati një përmirësim të përgjithshëm.

Së dyti, kishte një qëndresë të fortë në fillim të etapave të para të modernizimit, dhe përleshjet e para me forcat elitare osmane në Bosnjë filluan më 1851, si rezultat i të cilave mijëra njerëz humbën jetën.

Me ardhjen e dijetarit të madh mendjehapur Ahmed Xhevdet Pasha dhe politikës së tij të urtë dhe qasjes graduale, mendësia e dijetarëve boshnjakë u pasurua dhe ndërgjegjja e tyre u frymëzua. Ai u përpoq t'i bindte ata se shfaqja e jetës moderne dhe botëkuptimi islam nuk kishin pse i kundërviheshin njëri tjetrit.

Së treti, pas bindjes së tyre në të njëjtin dhjetëvjeçar, sistemi i vilajetit u zbatua në bashkësinë boshnjakë, u ngritën gjykata, u hapën shkolla fillore, shtëpitë botuese nisën punën etj.

Sigurisht pati kundërpërgjigje nga intelektualë muslimanë boshnjakë që ishin tradicionalë dhe konservatorë kundër këtij projekti modernizues osman. Megjithatë, këto përgjigje u ndanë në disa kategori, duke ngritur pesë çështje të rëndësishme.

1. Ekzistonte një dilemë e madhe nëse duhej kryer hixhret apo nëse duhej qëndruar nën sundimin jo-musliman.
2. Një tjetër dilemë ishte nëse lejohet apo jo shërbimi në ushtri jomuslimane.
3. Dilema të tjera kryesore ishin: ngritja e Organizatës Bashkësore Muslimane, lidhjet institucionale me selinë e kalifatit dhe marrëdhëniet mes Islamit e kulturës evropiane.

Në rastin e hixhretit dhe shërbimit të muslimanëve në një ushtri jo-muslimane, intelektualët muslimanë boshnjakë u referoheshin verdikteve (*fetvave*) dhe trajtesave (*resa'il*) të vjetra ligjore klasike, duke bërë analogji dhe krahasime (*el-kijas vel-mukaraneh*), të cilat i zbatonin në kontekstin boshnjak.

Rili i ulemave ishte shumë i efektshëm dhe ndikues për t'i ndalur njerëzit nga shpërngulja në masë në vende të tjera. Kështu që ata vendosën të qëndronin në Bosnjë dhe të shërbenin në ushtri jo-muslimane, e cila ishte barrë shumë e rëndë për ta fillimisht. Ata kishin luftuar kundër sundimit autro-hungarez deri vonë, ndërsa tani duhej t'i shërbenin!

Lidhur me organizatën bashkësore muslimane, më vonë u ngrit administrimi sipas Sheriatit nën qeverinë e Hapsburgut, dhe udhëheqësi i ri fetar, pra Muftiu i Sarajevës dha leje për ngritjen e administratës fetare të ndarë nga zyra e prijësit suprem fetar osman (Shejhul-Islam) në Stamboll, që ishte në fuqi akoma në fazat e tij të fundit.

Shumë ndryshime të tjera të rëndësishme u futën në jetën boshnjake në lidhje me industrinë dhe transportin. Shumë qytete boshnjake u zhvilluan, dhe në lidhje me arsimin u ngritën shkolla të tipeve dhe modeleve të reja. Gjuha dhe alfabeti osman u ndërruan me boshnjakishten dhe alfabetin latin. Shpërndarja e gazetave filloi gjithashtu si kundërpërgjigje e shoqatave lexuese dhe më vonë

më 1990 në përfundim të procesit të transformimit u shfaqën partitë e para politike në një shoqëri shumëfetare e shumetnike të Bosnjës (Serbët – ortodoksë, kroatët – katolikë, dhe boshnjakët – muslimanë).

Dukej se ekzistonin akoma lidhje formale me zyrën e Shejhul Islamit dhe Kalifit, dhe me caktimin e Prijësit të Ri Fetar (Reisul-ulema) në Bosnjë, lëvizja panislame që u shfaq atje gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit të njëzetë e mbështeti këtë rast.

Anëtarët e lëvizjes pan-islame zhvilluan veprimtari të madhe në përkthimin e shkrimeve dhe artikujve me frymë pan-islame, dhe boshnjakët u dhanë pas përkthimit dhe popullarizimit të veprave më të rëndësishme të autorëve pan-islamë të kohëve moderne.

Në fund, autori i librit tregon se boshnjakët kishin një përvetësim përzgjedhës të kulturës evropiane në lidhje me jetën shoqërore dhe pranimin e modernizimit, duke e mbajtur ndërkaq të pacenuar fenë e tyre.

Pjesa e tretë

MERITAT E LIBRIT

Libri *BOSHNJAKËT DHE SFIDAT E MODERNITETIT*, nga i respektuari Prof. Dr. Fikret KARCIC ka ndryshuar shumë nga pikëpamjet, idetë dhe opinionet e mia personale për bashkësinë boshnjake. Këtë e them pa asnjëfarë teprimi.

Më poshtë vijnë disa nga përshtypjet dhe opinionet e mia rreth këtij libri të mrekullueshëm.

Së pari: Metodologjia dhe objektivi

Lidhur me objektivitetin, pyetjet që u shtruan nga autori në fillim të librit ishin:

1. Cili ishte projekti modernizues i Austro-Hungarisë,
2. Konteksti politik i modernizimit,
3. Modernizimi dhe politikat e tij,
4. Promovuesit e modernizimit,
5. Ndikimi i modernizimit në ekonomi, shoqëri,
6. Përgjigjet e dijetarëve boshnjakë ndaj sfidave të sjella nga modernizimi, sikurse migrimi, shërbimi në ushtri jomuslimane, organizata bashkësore muslimane, etj.

Të gjitha këto pyetje morën përgjigje nga autori i respektuar, të cilat ishin në përputhje të plotë me natyrën e pyetjeve.

Së dyti: Një shoqëri e fortë

Autori shkoqiti rreth shoqërisë muslimanë boshnjake në etapat e saja historike si komb i fortë musliman, plot energji në strukturën, shpirtin e themelet e besimit të vet. Kjo forcë u mundësoi atyre ta vendosnin të ardhmen e tyre në mënyrën e duhur.

Së treti: Niveli i lartë i arsimit

Historia e shoqërisë muslimane boshnjake tregoi nivelin e lartë të arsimit të tyre islam dhe horizontin e gjerë të intelektualëve të saj, lidhur me të kuptuarit e rregullave të Sheriatit dhe zbatimit të tij. Për një shembull konkret mund t'u referohemi çështjeve të përmendura më sipër, të cilat u shtjelluan gjerësisht, sikurse migrimi dhe shërbimi në ushtri jomuslimane etj. Të gjithë këta gurë kilometrikë mund të shihen kur analizojmë shqetësimin e tyre me modernizimin dhe refuzimin e tij në etapat fillestare të futjes së reformave të Tanzimatit nën sundimin hapsburgas.

Së katërti: Një shembull i shkëlqyer

Shoqëria muslimane boshnjake ka dhënë një shembull të shkëlqyer për të gjithë muslimanët në mbarë botën, lidhur me ruajtjen e identitetit të tyre dhe themeleve fetare, në përballjen me sfida nga qytetërime të ndryshme. Kështu, ata nuk zgjodhën idenë që bën thirrje për përplasje qytetërimesh.

Së pesti: Përzgjedhja selektive e kulturës moderne evropiane

Ata nuk zgjodhën refuzimin tërësor të kulturës perëndimore dhe modernitetit të saj. Duke përvetësuar metodën selektive, siç ka treguar Imam Ebu el-Hasan Ali el-Nadawi, ata ishin në gjendje ta ruanin fenë e tyre tradicionale, Islamin, dhe të zgjidhnin ç'është e mirë dhe e dobishme për vendin e tyre në zhvillim, lidhur me teknologjinë, industrinë, bujqësinë dhe arsimin.

Së gjashti: I shkruar nga një dijetar i spikatur

Libri është shkruar nga një dijetar i spikatur dhe i aftë, i cili kaloi shumicën e jetës duke studiuar dhe shkruar për historinë e muslimanëve të Bosnjës gjatë katër regjimeve që përmendëm më herët. Kjo më mundësoi të kuptoja më mirë çfarë ka ndodhur në historinë boshnjake.

Për më tepër, profesori i nderuar është vendas. Njohja e tij me historinë osmane dhe ballkanase është e gjerë dhe e thellë, pa lënë vend për kritika. Veç kësaj, ai zotëron mirë disa gjuhë: arabisht, anglisht, turqisht, boshnjakisht, dhe mendoj se ai njih edhe bazat e gjermanishtes dhe persishtes.

Së shtati: Referencë dhe hyrje e rëndësishme

Në këtë pikë do t'i sugjeroja çdo intelektual që kërkon të kuptojë të kaluarën e shoqërisë boshnjake muslimane, t'i referohet së pari këtij libri si udhërrëfyes i fortë dhe hyrje e rëndësishme islame të historia e atij kombi.

Së tethti: Diskutim pa fanatizëm i pikëpamjeve

Autori është mjaft objektiv dhe nuk tregon asnjë fanatizëm në studimin e tij. Diskutimet dhe analizat e tij mbështeten mbi dokumente historike dhe burime të sakta. Si shembull mund t'i referohemi drejtshkrimit të emrit Kosova nga ana e tij, në faqet 45, 46, me 'a' e jo me 'o'. Serbët dhe vendet perëndimore përdornin formën Kosovo, por kjo është e gabuar dhe përbën keqshkrim, sipas burimeve vërtetësore historike shqipe.

Së nënti: Përfundimet mbështeten në hyrje të forta:

Rezultatet, që pasqyrohen tek opinionet e autorit në përfundimin e tij, mbështeten në ide, analiza dhe themele të forta, të cilat e kanë bërë fitimtar në këtë përpjekje vendimtare historike.

Së dhjetë: Pranimi i modernitetit dhe autori modern

Nuk ka rrëzim të modernitetit nga autori. Mbështetur në këtë, mund të konkludojmë se ai i përket studiuesve modernistë, nëpërmjet përvetësimit përzgjedhës të kulturës evropiane dhe qytetërimit të saj.

Pjesa e katërt

MANGËSI TË LIBRIT

Kritika të përgjithshme

1- Jetëshkrime të pamjaftueshme për shumë personalitete e dijetarë të rëndësishëm

Pikësëpari, kjo vepër është një histori e shkurtër e Bosnjës, kështu që nuk ka justifikim të përjashtohen disa personalitete të rëndësishme, pa të paktën një jetëshkrim të shkurtër. Mes këtyre personaliteteve janë autorët dhe dijetarët e famshëm si Shakib Arslan, Sheikh Rashid Rida, Imam el-Sarakhsij dhe shumë të tjerë. Vetëm në tre raste autori ka dhënë jetëshkrime të shkurtra.

Për shembull, kur ai dha një jetëshkrim të Muftiut të Sarajevës së asaj kohe, Mehmet Teufik Azapagic, kjo ishte diçka shumë me vend. Përkundrazi, nuk ka jetëshkrime për Muftiun e Mostarit, Mustafa Sidki Karabeg. Gjithashtu nuk ka jetëshkrim as të Imam Besjunit etj.

Edhe një rast tjetër në të cilin profesori i respektuar nuk dha as një përkufizim të shkurtër për sektet më të devijuara islame sikurse druzët; kush janë ata, ku ndodhen, cilat janë bindjet e tyre?

Në këtë kontekst, profesori i nderuar duhet të kishte dhënë njëfarë shpjegimi për disa terma filozofikë që ka përdorur në libër, sikurse *racionalizëm*, *naturalizëm*, dhe *pozitivizëm shkencor* (fq. 13-27), sepse çdojëra prej këtyre fjalëve ka kuptim të ndryshëm në filosofi, shkencë, histori, etj.

Në disa raste, autori nuk ka bërë aspak komente apo shkoqitje të disa ngjarjeve kritike historike. Për shembull, ai citon pa kurrfarë reagimi apo kritike fjalët e gjeneralit fanatik serb Josip Filipovic, se:

“Popullata muslimane, ndryshe nga përshtypjet e mia të mëparshme, është vërtet një turmë shtazësh të egra, që mund të sillet në vetëdije njerëzore vetëm nëpërmjet një çarmatimi tërësor të mbështetur në ligje të rrepta” (f. 83).

Pohimi i mësipërm është shumë i rrezikshëm, i pandjeshëm dhe fyes për të gjithë muslimanët.

Ne si muslimanë duhet t'i shqyrtojmë këto ngjarje historike të së kaluarës me seriozitet. Ne duhet ta mbrojmë fenë tonë të dashur islame nga armiqtë e saj, e jo vetëm të regjistrojmë dhe shkruajmë çfarë kanë thënë ose bërë njerëzit në të

shkuarën. Terma të tilla si i egër, terrorist etj, janë fyes dhe feja jonë nuk ka ardhur për të na bërë të egjër, të pamëshirshëm, ose terrorizues të të pafajshmit.

Edhe një rast tjetër, në të cilin shohim se profesri i respektuar nuk ka bërë asnjë koment rreth pohimit të austriakut Hugo Kutscher, i cili ishte kryetar i administratës civile në Bosnje për 22 vjet. Ai mbante në zyrë një kopje të Kur'anit Fisnik, të cilin e lexonte nganjëherë. Gjithashtu ai organizonte festime mevludi dhe tubime të tjera për muslimanët në residencën e tij! (f. 85)

Për mendimin tim, duhet të kishte patur njëfarë komenti kritik rreth këtij veprimi të kryer nga një jomusliman, sepse mund të jetë bërë edhe me hipokrizi, pa ndonjë nijet fisnik, e jo sepse admironte apo respektonte Islamin dhe ndjekësit e tij, por për shkak të mundshëm të ndonjë konspiracioni ose mashtrimi.

Të huajt kanë ndjekur gjithmonë këtë lloj propagande, të cilën e vazhdojnë saherë dëshirojnë të pushtojnë vende muslimane. Ata i mundin muslimanët me taktika dhe parulla si “Vendosja e demokracisë dhe lirisë e popujve të shtypur”, “Ndreqja e dhunimeve të të drejtave të njeriut” etj.

Në këtë çështje të veçantë, mund t’i referohemi rastit të Napoleon Bonapartit I. Kur erdhi në Egjipt në fillim të pushtimit dhe misionit të tij në Lindjen e Mesme, prijësi frëng u tha muslimanëve të Egjiptit: “Zoti Fuqiplotë më ka dërguar t’ju sundoj me kadanë dhe kaderin e Tij, kështu që nuk mund të më kundërshtoni, por duhet të tregoni respekt të plotë dhe nënshtrim ndaj Zotit tuaj!”

Ndaj, ne si intelektualë muslimanë duhet të jemi të vetëdijshëm për gënjeshtra dhe kurthe të tilla, dhe duhet t’u përgjigjemi këtyre ngjarjeve të rëndësishme qoftë edhe shkurtimisht në shkrimet tona.

Disa çështje bashkëkohore islame sikurse migrimi, shërbimi në ushtri jomuslimane, kalifati, pan-islamizmi, Perandoria osmane, etj janë diskutuar shumë shkurt në libër, veçanërisht çështja e fundit. Cilat ishin shkaqet kryesore për tatëpjetën dhe shkatërrimin përfundimtar të saj? A është i mundur rikthimi i saj?

Disa verdikte islame u lëshuan nga dijetarë të shquar islamë sikurse *al-Shaikh Muhammed Rashid Rida*, të cilat kishin të bënin me muslimanët e Bosnjës, dhe dijetarët islamë theksuan se këto verdikte nuk mund të përgjithësohen dhe të zbatohen për muslimanë t tjerë nëpër botë, përveçse në raste analoge.

Megjithatë, këto verdikte treguan nivelin e ndryshëm të opinionëve dhe pikëpamjeve të dijetarëve islamë të Bosnjës, të kuptuarin e tyre të gjerësishëm e të thellësishëm të çështjeve bashkëkohore politike, ekonomike dhe fetare.

Pozita e myftiut është një post shumë i lartë në Islam. Duhet të mbajmë parasysh se ka dallime mes termave islame si: Kryemufti, Kadi, Ka'id (prijës) dhe Mufekkir (mendimtar) etj.

Nëse e kuptojmë drejt këtë përkufizim të rëndësishëm dhe vendimtar islam mund të konkludojmë se pohimi i lëshuar nga kërkuesi i ri boshnjak Sulejman Muhamed Tubulijak ka qenë i paqartë dhe i pasaktë, veçanërisht komentet e tij rreth kuptimit të ajetit 60 të Sures el-Enfal.

Komentet e tij nuk lidheshin drejpërsëdrejti me çështjen e shërbimit të një muslimani në një ushtri jomuslimane. Përkundrazi, në ajetin e përmendur ka një urdhër nga Allahu i Madhërishëm për t' luftuar armiqtë e Tij dhe armiqtë e muslimanëve. Allahu Fuqiplotë thotë:

Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t'ju shpërblehet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi. (el-Enfalë: 60)

Mund të ketë ndodhur ndonjë keqcitim ose keqkuptim i ajetit paraprirës që lidhet me këtë çështje. Po, ajeti 61 lidhet *tërthorazi* me shërbimin në një ushtri jomuslimane, sepse flet për gjetjen e rrugëve për paqe me jomuslimanët. Allahu thotë në Kur'anin Fisnik:

Nëse ata shfaqin prirje për paqe, atëherë edhe ti ano nga ajo dhe mbështetu tek Allahu, sepse, vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka. (el-Enfalë: 61)

Pasi kuptohet ky realitet, mund të konkludohet se pohimi i dijetarit të ri boshnjak Sulejman Tubulijak që është cituar në librin në fjalë:

“...shërbimi në ushtri jomuslimane, nën kushtet ekzistuese dhe me nijetin e mirë, është jo vetëm i lejueshëm (xha'iz) por edhe i detyrueshëm (waxhib).”¹

Pohimi i tij “kushtet ekzistuese” është i paqartë dhe nuk është shjeguar mjaftueshëm. Nuk ka sqarim se ku e ka fjalën autori. Cilat janë këto kushte ekzistuese? A po e lufton qeveria e tanishme Islamin dhe po i shtyp muslimanët apo jo? Ose, a është qeveria sekulare, në të cilën feja është e ndarë krejtësisht nga politika ose jeta e njerëzve?

¹ Fikret Karcic, *The Bosniaks and the Challenges of Modernity*, f. 123.

Po ashtu, pohimi i tij “me nijet të mirë” është i ngjashëm. Ai duhet sqaruar dhe duhet të ketë më shumë hollësi rreth këtyre qëllimeve të mira.

A janë ata që shërbejnë në një qeveri jomuslimane të sëmure ose të plakur? A kanë zgjedhje për të migruar në një vend më të sigurtë dhe më me kushte? Apo kanë vendosur të qëndrojnë e të shërbejnë në atë ushtri jomuslimane me dëshirën dhe fuqinë e tyre, me nijetet e mira dhe zemrat e pastërta, duke ia dorëzuar fatin e tyre kaderit të Allahut?

Të gjitha këto opsione dhe mundësi nuk janë diskutuar nga dijetari i ri i respektuar boshnjak. Në prani të këtyre kushteve do të pajtoheshja me të specifikisht dhe posaçërisht nën këto rrethana, përndryshe jo.

E theksoj këtë sepse ka vargje në Kur'anin Fisnik që lidhen drejpërsëdrejti me këto çështje. Allahu i Madhërishëm thotë në Librin e Tij fisnik:

Kur engjëjt ua marrin shpirtat atyre që e kanë ngarkuar veten me fajë, u thonë: “Ku ishit?” Ata përgjigjen: “Ishim të pafuqishëm në Tokë”. (Engjëjt) do t’u thonë: “A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të?” Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi; eh, sa i keq është ai vendbanim! Me përjashtim të meshkujve të pafuqishëm, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë, mbase Allahu i fal, se Allahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynaheve.

1

(en-Nisa’: 97-99)

Mbështetur në recenzimin tonë dhe analizat e mësipërme, mund të konkludojmë se studiuesi dhe kërkuesi i ri boshnjak si dhe disa autorë kanë folur rreth këtyre çështjeve si mendimtarë e kërkues e jo si muftinj, pra një person i autorizuar që ka të drejtën për të dhënë verdikte ligjore për muslimanët në nivel vendi ose shteti. Kësisoj, idetë dhe opinionet e tyre mund të pranohen ose të refuzohen. Mendimtarët dhe kërkuesit islame nuk kanë të drejtë të lëshojnë fetva për çështje të ndryshme bashkëkohore politike, ekonomike dhe shoqërore. Nëse kanë thënë të drejtën, do të ketë dy shpërblime për ta, ndryshe vetëm një.²

Sa për opinionin e dijetarit indian Abdu Rrahman Doi (f. 122), ai m’u duk shumë i çuditshëm dhe mëse i devijuar nga udha islame (Kur'an dhe Sunnet). Si mund të jepte opinione të tilla, se pjesëtarët e një pakice muslimane duhet të shërbejnë në ushtrinë e vendit të tyre dhe se “duhet³ të tregojnë besnikërinë e

² Nuk arrita të gjej arsye përse profesori i nderuar nuk ka përmendur disa prej ideve, komenteve, apo fetvave të dijetarit të famshëm boshnjak Prof. Husein Djozo (Allahu e mëshiroftë), i cili lëshonte verdikte për çështje të ndryshme gjatë regjimit komunist në ish-Jugosllavi.

³ *The Bosniaks and the Challenges of Modernity*, f. 122.

tyre ndaj vendeve ku jetojnë edhe sikur të jenë jomuslimane dhe të luftojnë kundër një shteti musliman”?!

I respektuari Prof. Dr. Fikret Karcic nuk duhet të kishte heshtur pas citimit të këtij pohimi. Unë besoj fuqimisht se kushdo që shkruan vepër ose punim duhet të paktën të bëjë një koment të shkurtër në margjinat e librit, ose duke e kritikuar ose duke e lavdëruar materialin e cituar, jo thjesht duke mbledhë ide dhe fjalë pa analizë. Shpresoj se profesori i nderuar do t’i rishikojë disa nga idetë e tija në botimet e ardhshme të librit, duke shtuar komente të reja me dobi për lexuesit.

Po, muslimanët që jetojnë në vende jomuslimane nëpër botë duhet të jenë shumë besnikë, punëtorë, të sigurtë, të dashur, dashamirës ndaj vendeve mikpritëse. Mirëpo, nëse vendi ku janë bërë qytetarë lufton një shtet musliman, duke i shtypur muslimanët nëpër botë, ata nuk duhet të rrinë të heshtur. Ata duhet ta kundërshtojnë këtë politikë, këtë shtypje me mjete paqësore e demonstrata. Dhe sigurisht, nëse thërren të shërbejnë në ushtri, për të shkuar në luftë kundër muslimanëve nëpër botë, ata duhet t’u mosbinden urdhrave të vendit të tyre duke u thënë se kjo është kundër fesë së Islamit, kundër Kur’anit dhe traditës profetike.

Lidhur me disa fetva të dhëna nga disa persona të autorizuar të Bosnjës, sikurse muftiu i atëhershëm i Sarajevës Mustafa Hilmi Hadziomerovic dhe muftiu i Tuzlës Mehmed Teufik Azapagic, i cili më vonë u bë kreu i administratës muslimane në Bosnjë, ato ishin shumë më të afërta me Sheriatin.

Kurse sa i përket pohimit të muftiut Azapagic se hixhreti i sotëm nuk mund të krahasohet me hixhretin që ndodhi në kohën e Pejgamberit a.s., sepse ata u kthyen fitimtarë në Mekë më pas, më duhet të mospajtohem me të në këtë pikë, për arsyet e mëposhtme:

Sipas rregullave të parimeve të jurisprudencës islame, dijetarët kanë thënë: **saherë që shkaku i një gjykimi është i pranishëm, kthimi i atij shkaku kthen gjykimin.** (*el-il'latu jaduru ma' el-hukmi vuxhuden va adamen*).

Ajo që nënkuptoj me këtë përkufizim është se shkaqet kryesore të hixhretit të muslimanëve të parë në Medinë që ndodhi në periudhën Mekase ishin: të qenurit e muslimanëve nën shtypje të rëndë, persekutim të gjatë, agresion nga politeistët e Mekës. Nuk kishte liri fjale ose ushtrimi të fesë. Këto ishin arsye logjike që i shtynë muslimanët e hershëm të largoheshin nga Meka.

Megjithatë, mësimi që mund të nxirret nga kjo ngjarje e historisë islame është se, ndonëse nuk e kishim nderin ta shoqëronim të Dërguarin e Allahut a.s. dhe sahabët e tij në migrim për të marrë disa nga shpërblimet e tij të veçanta, ne

duhet të besojmë se migrimi bëhet i detyrueshëm kurdo që kushtet e hixhretit kthehen përsëri. Ky është një shpjegim i shkurtër rreth një çështjeje kaq vendimtare si kjo.

E fundit, por jo për nga rëndësia, është ndodhia e zonjës muslimane Fata Omanovic (f. 130). Kjo grua e re u mor peng nga murgeshat katolike dhe foli për konspiracionin e tmerrshëm dhe të mirëplanifikuar kundër muslimanëve boshnjakë nën sundimin hapsburgas.

Është shumë e trishtueshme që kjo ngjarje e rëndësishme historike është regjistruar pa kurrfarë komentesh ose kritike nga autori. Mendoj se kjo mënyrë studimi e historisë duhet ndryshuar. Nuk do të ketë përparim për brezat e ardhshëm nëse kjo metodologji e studimit të historisë mbetet e njëjtë. Ideja e mendimtarit islam Sejjid Kutb duhet ndjekur dhe zbatuar në studimin e historisë. Ajo mbështetëj në thirrjen për të ndjekur metodologjinë islame në studimin e historisë.

Pjesa e pestë

Një kritikë e jashtme

Kur krahasojmë librin *THE BOSNIACS AND THE CHALLENGES OF MODERNITY*, të shkruar nga Prof. Dr. FIKRET KARCIC dhe kontekstin e tij, me përmbajtjen dhe kontekstin e librit: *ISLAM AND THE MODERN MUSLIM WORLD*, të shkruar nga GOLAM W. CHOUDHURY⁴ për shembull, do të shohim se autori i dytë ka qenë shumë më pranë perceptimit islam të idesë së modernitetit në diskutimin e tij, dhe çështja e modernitetit është diskutuar nga pikëpamja islame në tërësinë e vet, lokalisht dhe ndërkombëtarisht.

Ndërsa profesori i respektuar është fokusuar më shumë te perceptimi historik i modernitetit, sesa tek qëndrimi islam ndaj tij, dhe çështjet e modernitetit dhe modernizmit janë diskutuar lokalisht, në nivelin e një shteti (Bosnje Hercegovina), si një historian dhe autor islam i barazpeshuar.

Le të shohim më pranë përmbajtjen e librit të dytë, thjesht për të krahasuar mes tyre, dhe do të shohim se temat e tij që janë shtjelluar edhe këtu, janë parë nga përmasa të ndryshme:

⁴ Professor G.W.Choudhury është një studiues musliman me famë botërore. Ai ka botuar një numër mbresëlënës librash dhe artikujsh në SHBA, Kanada, Britani, etj. Ai ishte ministër qeverie në Pakistanin e pandarë të vitit 1971. Sot ai jep mësim rreth Islamit dhe Modernizmit në Shkollën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Publike të Universitetit Kolumbia, në Nju Jork. Ai i kushton shumë energji fshatit të largët ku kanë lindur ai dhe të parët e tij në Bangladesh. Vepra e tij ***The Prophet Muhammad: His life and Eternal Message*** është botuar së fundmi, ndërsa libri ***Pakistan: Transition from Military to civilian Rule***, po zgjerohet dhe do të ribotohet.

<i>Kreu i</i> -----	5
Bazat e Islamit	
<i>Kreu ii</i> -----	39
Rendi politik në Islam	
<i>Kreu iii</i> -----	67
Fillimi i rendit islam	
<i>Kreu iv</i> -----	95
Islami në kombshitetet moderne	
<i>Kreu v</i> -----	127
Islami në botën joarabe	
<i>Kreu vi</i> -----	163
Drejt vendit musliman ideal joarab: Malajzia	
<i>Kreu vii</i> -----	171
Teoria islame e marrëdhënieve ndërkombëtare	
<i>Kreu viii</i> -----	189
Ringritja e Islamit	
<i>Kreu ix</i> -----	215
Fundamentalistët islamikë: A është Islami kërcënim për paqen në botë?	

Kreu i gjashtë

PËRFUNDIM

Si përfundim, do të doja të shpreh falënderimet nga zemra dhe ndjenjat e sinqerta ndaj profesorit tim të nderuar, autorit të këtij libri, për të cilin u nderova duke u zgjedhur si recenzues kritik i tij. Ndërkohë që i nderuari më jepte mësim kursin e Metodologjisë kërkimore, gjat studimeve të mia të doktoraturës në Universitetin Ndërkombëtar të Malajzisë. Nëpërmjet këtij punimi të sinqertë dhe të thellë mbi historinë e shoqërisë muslimane boshnjake, ai arriti të qartësonte, analizonte, zbulonte dhe diskutonte shkencërisht si një dijetar islam modern, i barazpeshuar dhe historian i spikatur, sfidat më të mëdha me të cilat u përball shoqëria muslimane boshnjake gjatë dyzet viteve të sundimt habsburgas, dhe kjo ishte një ndihmesë vërtet e madhe.

Nuk kishte fanatizëm të verbër në diskutimin e këtyre çështjeve të ndjeshme. Kritikën e mia të përgjithshme dhe komentet e veçanta nuk e zhvleftësojnë aspak këtë referencë të rëndësishme historike. Ato kritika janë një kontribut modest ndaj këtij studimi, në mënyrë që libri të bëhet më efektiv dhe ndikues.

Allahu i Madhërishëm (S.V.T.) derdhtë mëshirën dhe ndihmën e tij mbi profesorin tim të dashur dhe ne, duke e shpëblyer gjithashtu për punën e tij të shkëlqyer. AMIN

Dr. Hajredin Hoxha

Departamenti i Shkencave Humane dhe Teknologjisë
Community College – Universiteti Taibah
Medina e Ndritshme – Mbretëria e Arabisë Saudite
18.07.2009